



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 1016 Prot.
16

Patos, më 27 10/9/2026

PROCESVERBALI I TAKIMIT 27 PRILL 2026

Vendi: Salla e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Patos

Ora e fillimit: 14:00

Ora e mbarimit: 15:00

Dëgjuesë publike me temë: “Marrja e kërkesave prioritare mbi hartimin e PBA-së 2027-2029”.

Baza Ligjore: Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe VKB nr. 83, datë 17.12.2025 “Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2027-2029 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2027”.

Pjesëmarrës: Sekretare e Këshillit znj. Refaela Xeba, Zv/ Kryetare znj. Ina Sauli, Drejtore e Financave znj. Mimoza Shtëmbari, Anëtarë GMS, përfaqësues të bashkisë Patos, me pjesëmarrjen e **52 pjesëmarrës** (banorë, të rinj të qytetit dhe shoqërisë civile, përfaqësues të institucioneve arsimore, nxënës etj)

Takimin hapet nga sekretare e Këshillit znj. Refaela Xeba

Sekretare e Këshillit znj. Refaela Xeba- Përshëndetje! Ju falenderoj që jeni bërë pjesë të



**Sekretare e Këshillit
znj. Refaela Xeba
Dëgjuesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029”.
Prill 2026**

kësaj dëgjese publike. Tema e kësaj dëgjese është “Marrja e kërkesave prioritare mbi hartimin e PBA-së 2027-2029”. Është e nevojshme dhe e domosdoshme të bashkëpunojmë me të rinjtë e qytetit dhe institucionet arsimore në lidhje me kërkesat apo probleme të ndryshme që ka në territorin e bashkisë tonë, me qëllim që materiali përfundimtar i PBA-së 2027-2029 të jetë i plotë. Do ju lutesha që fjala të merrej me rradhë dhe të prezantoheshit gjatë kërkesave tuaja. Ju faleminderit!

Zv/ Kryetare znj. Ina Sauli- Përshëndetje! Faleminderit që na keni zbukuruar sallën sot me pjesëmarrjen tuaj. Mendimi i të rinjve ka rëndësi në hartimin e PBA-së. Jeni të mirëpritur për kërkesat që mund të keni në mënyrë që ne ti pasqyrojmë në dokumentin që do të hartohet.



**Zv/ Kryetare
znj. Ina Sauli**

**Dëgjesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029”.
Prill 2026**

Anëtar i KVR, Sokol Baxhia- Përshëndetje të gjithëve! Unë do të sugjeroja që përpara se të vendoseshin këto dëgjesa publike të ndërtohej një raport lidhur me dëgjesat që janë bërë edhe më parë me të rinjtë për të parë se sa efektive kanë qënë ato në marrjen parasysh të kërkesave që kemi bërë. Në këtë mënyrë mund të bëjmë dhe ne një rezyme se çfarë kërkesash të tjera duhet të shtojmë.



**Anëtar i KVR
Sokol Baxhia**

**Dëgjesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029”.
Prill 2026**

Drejtores e Financave, znj. Mimoza Shtëmbari- Ne jemi duke marrë kërkesat për vitin 2027 deri në 2029. Ato kërkesa që ju keni bërë më herët në dëgjesat e para janë në proces dhe

shqyrtim. Po flasim për kërkesa të reja për periudhën në vazhdim. Ju keni kërkuar internet, garderob për mbajtjen e mjeteve, foni për shkollat për aktivitete, qender rinore etj.



**Drejtoresh e Financave
znj. Mimoza Shtëmbari**

**Dëgjuesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029”.**

Prill 2026

Anëtare e Këshillit Bashkiak, znj. Vjollca Kasaj – Përhëndetje! Ne kemi kërkuar foni dhe qender zëri për shkollat pasi është e nevojshme për tu përdorur për aktivitete që shkollat realizojnë.



**Anëtare e Këshillit Bashkiak
znj. Vjollca Kasaj**

**Dëgjuesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029”.**

Prill 2026

Nxënëse në shkollën “Meleq Gosnishti”, Ermonela Muskaj- Përhëndetje! Unë mendoj që



**Nxënëse në shkollën “Meleq Gosnishti”
Ermonela Muskaj**

**Dëgjuesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029”.**

Prill 2026

duhet të merren më shumë iniciativa për sjellen në jetë të më shumë projekteve për të rinjtë duke përfshirë fushën e edukimit dhe shumë fusha të tjera të ndryshme në varësi të interesit të tyre. Pra duhet të ketë më shumë projekte nga OJF në mënyrë që të përfshihen të rinjtë.


Zv/ Kryetare, znj. Ina Sauli- Porjektet që vijnë nga OJF janë thirrje të cilat hapen dhe në momentin që ne si bashki aplikojmë dhe fitojmë atëherë angazhohen dhe të rinjtë në aktivitete. Aktualisht nuk ka projekt të tillë në zbatim.



**Zv/ Kryetare
znj. Ina Sauli**

**Dëgjesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029”.
Prill 2026**

Anëtar i KVR, Sokol Baxhia- Unë kam dhe një kërkesë për një qender rinore pasi Patosi nuk ka një të tillë. Kërkojmë të ketë një qendër rinore për të rinjtë në mënyrë që të angazhohen të rinjtë dhe të shtohen aktivitetet dhe iniciativat për të rinjtë nga bashkia. Ne kemi pothuajse të njëjtat kërkesa çdo vit siç janë këndet sportive, interneti në shkolla, këndet sportive, fonia. Kemi kërkuar edhe bazë materiale për teatër dhe për vënie në punë të klubeve teatrale. Ne kemi kërkuar hapjen e klubeve të ndryshme. Psh. Pallati i Kulturës mund të hapi një klub për teatrin dhe shfaqjet teatrale dhe sigurisht që aty kërkohet edhe një bazë materiale. Ne kërkojmë që qendra rinore të jetë e hapur dhe e përhershme dhe projektet të zgjasin në kohë apo klube të ndryshme që tu japin mundësi të rinjve.



**Anëtar i KVR
Sokol Baxhia**

**Dëgjesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029”.
Prill 2026**

Mësues në shkollën “Muhamet Shehu”, z. Elis Beluli- Unë doja të shtoja që në vitin e kaluar kur u bë shfaqja teatrale e gjimnazi mësuesi i letërsisë ka paguar vet shpenzimet e shfaqjes. Këta të rinj u bënë fitues të çmimit të parë të Festivalit të Shkencës dhe i kanë paguar vet shpenzimet që u janë nevojitur për të zhvilluar këtë aktivitet.



**Mësues në shkollën “Muhamet Shehu”
z. Elis Beluli**

**Dëgjesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029”.
Prill 2026**

Drejtoreshë, znj. Irisi Xhelaj- Shumë bazë materiale i është vendosur në dispozicion shkollën



**Drejtoreshë
znj. Irisi Xhelaj**

**Dëgjesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029”.
Prill 2026**

së mesme lidhur me realizimin e shfaqjes teatrale dhe mësuesitë letërsisë. Për sa i përket qendre rinore që u përmend, qendra ka qene aktive, keni bërë dhe çorkshope dhe trajnime nga OJF. Si çdo bashki tjetër ka muaj që janë pause dhe nuk ka projekte në vazhdimësi për arsye sepse nuk ka projekte të financuara nga donatorë. Për një bashki të vogël si Patosi që të vendosësh një buxhet të dedikuar për rininë është e vështirë. Megjithatë me gjithë këto vështirësi si bashki ne kemi arritur të realizojmë disa aktivitete dhe të angazhojmë të rinjtë në projekte me OJF.

Anëtare e Këshillit Bashkia dhe mësuese në shkollën “Muhamet Shehu”, znj. Vjollca Kasaj- Duke qënë se jemi në fund të vitit shkollor dhe bashkia do të filloj procesin e mirëmbajtjes në të gjitha shkollat, të shikohen pak me imtësi punimet që do të bëhen në shkolla. Ka shkolla që kërkojnë punime specifike në të gjitha elementët. Kërkesat do të vijnë

edhe nga drejtoritë e shkollave. Është bërë një punë e mirë për pajisjen me stola. E mira do të ishte që nqse bashkia ka mundësi të shtojë edhe disa stola të tjerë në shkola pasi numri i nxënësve është i madhe dhe ka nevojë. Te shkolla "Muhamet Shehu" të bëhet një prerje e pemëve sepse kanë zgjeruar kurorën e tyre dhe krijojnë problematika. Kangjellat rrethues në disa shkolla kanë disa vite pa u lcyer.



**Anëtare e Këshillit Bashkia, mësuese
"Muhamet Shehu"
znj. Vjollca Kasaj**

**Dëgjesë publike me temë:
"Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029".**

Prill 2026

Drejtoreshë e Emergjencave Civile dhe Zhvillimit të Territorit, znj. Boreta Murati- Si çdo vit dhe këtë vit do bëhet mirëmbajtja e shkollave dhe janë bërë verifikimet në çdo shkollë. Gjatë vitit ne kemi të njëjtat probleme dhe vet nxënësit duhet të ndërgjegjësohen lidhur me këto dëmtime pasi ka patur dëmtime të mëdha lidhur me materiale të rëndësishme si thyerja e dverve të emergjencës, dëmtimi i tubove etj.



**Drejtoreshë e Emergjencave Civile dhe
Zhvillimit të Territorit
znj. Boreta Murati**

**Dëgjesë publike me temë:
"Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029".**

Prill 2026

Drejtoreshë në kopshtin Nr. 2 znj. Flutura Kodheli- Unë do të kërkoja lidhur me kopshtin në



**Drejtoreshë në kopshtin Nr. 2
znj. Flutura Kodheli**

**Dëgjesë publike me temë:
"Marrja e kërkesave prioritare mbi hartimin
e PBA-së 2027-2029".**

Prill 2026

Oficinë nëse mund të bëhet ndarja e oborrit në dy pjesë për fëmijët në mënyrë që të jepet hapësirë kur dalin fëmijët e vegjël dhe të mos përzihen me ata më të mëdhenjt. Të jetë dhe një minikënd të vogël për fëmijët që të kenë mundësi të luajnë. Kopshti i Grizës duhet të pastrohet oborri nga bari.

Zv/ Kryetare, znj. Ina Sauli- Nëse nuk keni diçka tjetër e deklaroj të mbyllur këtë dëgjesë. Faleminderit!



**Zv/ Kryetare
znj. Ina Sauli**

**Dëgjesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029”.**

Prill 2026

Koordinatorë e Konsultimit Publik

Simela Shahinaj

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Refaela Xeba